



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

TË DHËNA MBI VENDIMIN Nr. 63 _ Datë 26.06.2018

MONITORIM I KRYER NGA APP

Autoriteti Kontraktor	DREJTORIA RAJONALE E AUTORITETIT KOMBËTAR TË USHQIMIT GJIROKASTËR
Hetim administrativ, iniciuar nga	• APP ☐ • Reklamim nga të tretë x
Numri i procedurave të monitoruara	1
Lloji i procedurës/ave të monitoruara	Procedurë prokurimi me vlerë të vogël
Konstatimet kryesore	Nga shqyrtimi i gjithë informacionit të administruar në kuadër të hetimit administrativ dhe kundërshtimeve të dërguara nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Prokurimit Publik arrin në përfundimin se, autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar dhe dokumentuar përlllogaritjen e fondit limit, duke vepruar në kundërshtim me nenin 28, pika 3, të ligjit të prokurimit publik dhe nenin 59 të Rregullave të Prokurimit Publik. Gjithashtu, autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar përcaktimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit, duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 61 të Rregullave të Prokurimit Publik. Autoriteti kontraktor ka vepruar në kundërshtim me nenin 46 të Ligjit të Prokurimit Publik, pasi për kriteret e kualifikimit të përcaktuara në ftesën për ofertë (ka kërkuar që ofertuesit të paraqesin, deklaratat e plotësuara bashkëlidhur ftesës për ofertë, të cilat nuk rezultojnë të jenë bashkëlidhur, autoriteti kontraktor ka kërkuar që kompania të ketë Server Backup, por nuk ka përcaktuar dokumentacionin konkret që duhet të paraqesin ofertuesit në përmbushje të kriterit në fjalë. Gjithashtu, autoriteti

	kontraktor ka kërkuar, sallë operative/pajisjet e komunikimit dhe faturat e blerjes së aparaturave në emër të shoqërisë, por nuk ka përcaktuar numrin e sallave operative dhe dokumentacionin konkret që duhet të paraqesin ofertuesit në përmbushje të kriterit. Autoriteti kontraktor duhet të kishte parashikuar mundësinë që ofertuesit të paraqesnin dhe dokumentacionin e marrjes me qira të pajisjeve të komunikimit dhe sallës operative, ka kërkuar deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve (automjete të ndërhyrjes së shpejtë, salla operative), shoqëruar me dokumentat që vërtetojnë pronësinë, por duhet të ishte parashikuar dhe mundësia e paraqitjes së dokumentacionit të marrjes me qira të këtyre mjeteve). Anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, nuk kanë deklaruar gjendjen e konfliktit të interesit me ofertuesit pjesëmarrës, në kundërshtim me nenin 64, pika 2, të Rregullave të Prokurimit Publik. Gjithashtu, nuk administrohet procesverbali për verifikimin e fushës së veprimtarisë së ofertuesve pjesëmarrës, në kundërshtim me pikën 14/a të Udhëzimit Nr. 3, datë 08.01.2018, “Mbi përdorimin e Procedurës së Prokurimit me Vlerë të Vogël”, i ndryshuar. Sa i takon procesit të vlerësimit të ofertave, autoriteti kontraktor ka kualifikuar dhe shpallur fitues operatorin ekonomik me mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me kërkesat e kualifikimit dhe me nenet 53, pika 3, dhe 55, pika 2, të Ligjit të Prokurimit Publik.. Autoriteti kontraktor nuk ka mbajtur procesverbal mbi verifikimin e dokumentacionit administrativo ligjor, në formë të shkruar, përpara finalizimit të procedurës, në kundërshtim me pikat 15 dhe 16, të Udhëzimit, Nr. 3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e Procedurës së Prokurimit me Vlerë të Vogël”, i ndryshuar
Masat e marra	Agjencia e Prokurimit Publik, në bazë të nenit 72, pika 2, të Ligjit të Prokurimit Publik, ka propozuar për marrjen e masës disiplinore për 3 (tre) persona, në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël.